

## SHTOJCA NR 1

### Per Kriteret per Kualifikim të Tenderit: **“Rikonstruksioni i Rrugës së Beratit (Plasmas – Karbunarë) Bashkia Lushnje”**

Kerkesat per kualifikim te procedures me objekt: **“Rikonstruksioni i Rrugës së Beratit (Plasmas – Karbunarë) Bashkia Lushnje”** ndryshojne dhe behen si me poshte :

#### Shtojca 12

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

#### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- b. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- c. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- ç. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- dh. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10*

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:**

Objekti i “Ndertim” duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit (2015, 2016 dhe 2017) duhet të mos jetë më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit pa tvsh. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

**2.2.2** Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë tre viteve 2015, 2016 dhe 2017. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të këtyre tre viteve, të paraqitura pranë autoritetit përkatës, të shoqëruara nga akt ekspertizë e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.

**2.2.3** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet për periudhën nga 1 janari 2017 deri në datën 15 gusht 2018. Kësaj deklaratë duhet të bashkëngjiten të gjithë vërtetimet që deshmojnë se operatori ekonomik ka paguar detyrimet përkatëse, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këtë periudhë, shoqëruar me mandatat përkatëse të pagesave.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur. Në rast deklarimi të rreme do të veprojë në përputhje me nenin 13, pikë 3, germa “a” të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, “Për Prokurimin Publik”.**

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit,

ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vlerës së fondit limit.

**Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë punët sipas tabelës së mëposhtme:

| NR | OBJEKTI I KONTRATËS | AUTORITETI KONTRAKTOR | VLERA E KONTRATËS PA TVSH | DATA E FILLIMIT TË PUNËVEVE OSE DATA PARASHIKUAR PËR LIDHJEN E KONTRATËS | DATA E PËRFUNDIMIT TË PUNËVEVE OSE DATA E PARASHIKUAR PËR PËRFUNDIMIN E PUNËVEVE |
|----|---------------------|-----------------------|---------------------------|--------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|
| 1  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |
| 2  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |
| 3  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |

|   |  |  |  |  |  |
|---|--|--|--|--|--|
| 4 |  |  |  |  |  |
| 5 |  |  |  |  |  |

Per secilen pune duhet te paraqiten formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkuara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese.

**2.3.2** Të ketë të punësuar minimalisht 75 persona për periudhën Shkurt 2018 – Gusht 2018, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për kete periudhë, shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG.

**2.3.3** Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.2 per kualifikim nuk jane te angazhuar ne kontratat qe operatori ekonomik ka aktualisht ne proces zbatimi.

**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij (sipas tabelës se meposhtme) me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV per secilin inxhinier, per:

- 1 (një) inxhinjer ndërtimi
- 1 (një) inxhinjer ndërtimi me profilin transport
- 1 (një) inxhinjer hidroteknik
- 1 (një) inxhinjer elektrik
- 1 (një) inxhinjer Gjeodet

| NR | INXHINIERI                             | EMRI MBIEMRI | SHOQERIA KU PUNON AKTUALISHT |
|----|----------------------------------------|--------------|------------------------------|
| 1  | Inxhinjer ndërtimi                     |              |                              |
| 2  | Inxhinjer ndërtimi me profil transport |              |                              |
| 3  | Inxhinjer hidroteknik                  |              |                              |
| 4  | Inxhinjer elektrik                     |              |                              |
| 6  | Inxhinjer gjeodet                      |              |                              |

Ne rastet e bashkimit te Operatoreve Ekonomike propozimi duhet te firmoset nga te gjitha shoqerite e bashkimit.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e kerkuar ne piken 2.3.4 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera qe operatori ekonomik ka aktualisht ne proces zbatimi dhe, ne rast se shpallen fitues per kete procedure, do te qendrojne ne objekt gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve.

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij mjekun e shoqerise, ne zbatim te VKM nr. 742, date 06.11.2003. Per kete duhet te paraqese kontraten e punes, diplomën, licensen perkatese dhe nje deklarate se mjeku eshte i regjistruar dhe per te paguhen rregullisht sigurimet shoqerore.

**2.3.7** Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.P – 1. A Punime gjurmimi në tokë.

N.P – 4. C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

N.P – 5. B Punime nëntokesore, vepra arti.

N.P – 11. A Ndërtim për nënstacionet, kabinat e transformatoreve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.S – 1. A Punime për prishjen e ndërtimeve .

N.S – 6. A Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

N.S – 18 A Punime topogjeodezike

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

1. Eskavator me zinxhire – 2 copë
2. Eskavator me goma – 2 copë
3. Grejder – 1 copë
4. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton – 4 copë
5. Kamionçinë (deri në 6 ton) – 2 copë
6. Gurëthyes, frontoje – 1 copë
7. Fabrikë asfalti – 1 copë
8. Autobitumatriçe – 1 copë
9. Asfalto-shtruese – 2 copë
10. Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 18 ton) – 2 copë
11. Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 12 ton) – 2 copë
12. Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo më pak se 8 ton) – 2 copë
13. Rrul asfalti me gome - gome (Kapaciteti jo më pak se 8 ton) – 2 copë
14. Kompresor ajri – 1 copë
15. Autobot uji – 1 copë
16. Freze asfalti – 1 copë
17. Autobetoniere – 1 copë
18. Mjet autovinç me kapacitet jo më pak se 12 ton – 1 copë
19. Fadrome Kove përpara dhe mbrapa – 1 copë

- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të

paraqiten kontratat e qerases, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor.

- Për mjetet vetelevizes që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; vertetimin e pagesës për taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerases.
- Për mjetet vetelevizes që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerases.
- Për fabrikën e asfaltit, nëse është në pronesi, duhet të paraqitet vendndodhja (në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti, për të garantuar hedhjen në veprë brenda kushteve teknike), kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore kodë III 1B lëshuar nga QKL dhe certifikata e kalibrimit. Nëse është marrë me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerases. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit mund të paraqesë edhe kontratën të vlefshme furnizimi me operatore ekonomike të zonës (në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti, për të garantuar hedhjen në veprë brenda kushteve teknike). Në këtë rast duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që verteton ekzistencën dhe pronesinë e impiantit.

**2.3.9** Makineritë e mesipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontratë të tjera që operatori ekonomik ka aktualisht në proces zbatimi. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mesipërme nuk janë të angazhuara në kontratë të tjera.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepruhet në përputhje me nenin 13, pikë 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".**

**2.3.10** Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pikë 1, paragrafi IIb. Për të provuar plotësimin e kësaj kërkesë duhet të deklarojë të gjitha punët në proces për të cilat ka lidhur kontratë apo është në proces të lidhjes së saj, si kontraktor apo nënkontraktor, sipas tabelës së mëposhtme:

| NR | OBJEKTI I KONTRATES | AUTORITETI KONTRAKTOR | VLERA E KONTRATES PA TVSH | DATA E FILLIMIT TË PUNIMEVE OSE DATA PARASHIKUAR PËR LIDHJEN E KONTRATES | DATA E PËRFUNDIMIT TË PUNIMEVE OSE DATA E PARASHIKUAR PËR PËRFUNDIMIN E PUNIMEVE |
|----|---------------------|-----------------------|---------------------------|--------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|
| 1  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |
| 2  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |
| 3  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |
| 4  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |
| 5  |                     |                       |                           |                                                                          |                                                                                  |

Gjithashtu operatori ekonomike duhet te paraqese nje vetëdeklarim që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

**2.3.11** Operatori Ekonomik duhet te disponoje çertifikatat:

ISO 9001:2015

ISO 14001:2015

OHSAS 18001:2007

Çertifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit, dhe te jene ne perputhje me nenin 30 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

**Afati per dorezimin dhe hapjen e ofertave ndryshon si me poshte:**

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte: Data: 05.10.2018 Ora: 10.00.

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje behet: Data: 10.10.2018 Ora: 10.00.**

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte: Data: 05.10.2018 Ora: 10.00.

**Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje behet: Data: 10.10.2018 Ora: 10.00.**

**Njësia e Prokurimit**